

*E DREJTA E ASOCIIMIT DHE
REGJISTRIMI I OJQ-SË*

E DREJTA E ASOCIIMIT DHE REGJISTRIMI I OJQ-SË

Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) mund të themelohet si shoqatë ose fondacion. Shoqata mund të themelohet nga së paku tre persona, ku njëri prej tyre duhet të jetë banor i përhershëm i Kosovës. Fondacioni mund të themelohet nga së paku një person me vendbanim të përhershëm në Kosovë apo përmes testamentit.

Edhe pse e drejta për themelimin të organizatës dhe veprimtari është e garantuar pa pasur nevojë për leje paraprake nga organet shtetërore, me qëllim të përfitimit të subjektivitetit juridik, regjistrimi i saj është i domosdoshëm. Organi kompetent për regjistrim të OJQ-ve në Kosovë është Departamenti për OJQ, në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Për të regjistruar një OJQ duhet të plotësohet kërkesa për regjistrim të OJQ-së – e cila merret në Departamentin për OJQ – dhe t'i bashkëngjiten dokumentet në vijim:

- Akti themelues i organizatës
- Statuti i organizatës
- Fotokopjet e dokumentit të identifikimit të themeluesve të organizatës
- Lista e anëtarëve të Kuvendit – për shoqata
- Lista e anëtarëve të Bordit – për fondacione

KËRKESA PËR REGJISTRIM TË OJQ-SË

- Emrin e plotë dhe shkurtësën e organizatës;
- Formën e themelimit të organizatës – shoqatë apo fondacion;
- Adresën e plotë të organizatës;
- Emrin e përfaqësuesit të autorizuar të organizatës.

AKTI THEMELUES I ORGANIZATËS

Akti themelues i organizatës është dokument përmes të cilit anëtarët e saj shprehin vullnetin dhe gatishmërinë për themelimin të organizatës bazuar në të drejtat dhe obligimet që dalin nga Ligji për OJQ. Akti themelues duhet të përmbajë informatat si:

- Emrin e organizatës;
- Formën e themelimit të organizatës – shoqatë apo fondacion;
- Adresën e plotë të organizatës;
- Misionin e organizatës;
- Informatat personale të themeluesve të organizatës:
 - Emri dhe mbiemri
 - Adresa e plotë
 - Numri i telefonit
 - e-mail adresa

Në fund, Akti themelues duhet të nënshkruhet nga të gjithë themeluesit e organizatës.

STATUTI I ORGANIZATËS

Statuti i organizatës është dokumenti kryesor përmes së cilit udhëhiqet organizata. Ai përmban rregullat dhe parimet e përgjithshme mbi qëllimin e themelimit të organizatës dhe qeverisjes së saj. Statuti i organizatës duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me kërkesat që dalin nga Ligji për OJQ.

Më konkretisht, Statuti i organizatës duhet të përmbajë së paku detajet si:

- Emrin e plotë të organizatës, shkurtësën (nëse ka) dhe simbolin identifikues (llogon);
- Adresën e plotë të organizatës;
- Qëllimin e themelimit të organizatës dhe aktivitet kryesorë në të cilat do të angazhohet organizata;
- Emrin e organit më të lartë vendim-marrës
 - Për shoqatë – Kuvendi i Anëtarëve
 - Për fondacion – Bordi i Drejtorëve
- Kriteret, rregullat dhe procedura e zgjedhjes dhe shkarkimit të strukturave udhëheqëse;
- Përcaktimin e mandatit të strukturave udhëheqëse
 - Për shoqatë, nëse Shoqata vendosë të ketë Bord:
 - Procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit si dhe mandati i anëtarëve të Bordit;
 - Ndarjen e përgjegjësive dhe kompetencave në mes të Kuvendit të anëtarëve dhe Bordit
- Mënyrën e marrjes së vendimeve;
- Kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve tjerë të organizatës (nëse ka);
- Rregullat dhe procedurat për ndryshimin e Statutit, bashkimin, ndarjen ose shuarjen e organizatës dhe shpërndarjen e mjeteve që mbesin pas shuarjes së organizatës.

Lista e anëtarëve të Kuvendit – për shoqata

Kuvendi i anëtarëve është organi më i lartë vendim-marrës tek shoqatat. Ai përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës. Kuvendi i anëtarëve duhet të ketë së paku 3 persona në përbërje të tij. Anëtarë të Kuvendit mund të jenë edhe vet themeluesit e shoqatës.

Lista e anëtarëve të Bordit – për fondacione

Bordi i drejtorëve është organi më i lartë vendim-marrës i organizatës dhe duhet të ketë së paku 3 persona. Përbërja e parë e Bordit përcaktohet nga themelues-i/it, kurse në vazhdim përzgjedhja bëhet bazuar në Statutin e organizatës.

ASOCIIMI I PERSONAVE JURIDIK NË OJQ

Kushtetuta e Kosovës garanton edhe lirinë e asociimit të personave juridik, kurse Ligji për OJQ trajton procedurën e themelimit të OJQ-së nga persona juridik. Përveç kërkesave të përgjithshme për themelimin të OJQ-së, në rastet kur kemi të bëjmë me themelues persona juridik ekzistojnë disa kërkesa shtesë:

- Dëshmia që personat të cilët themelojnë OJQ-në janë persona juridik – (*p.sh. Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së, Certifikata e Regjistrimit të Biznesit*); dhe
- Vendimi për caktimin e përfaqësuesit të personave juridik për themelimin e OJQ-së.

Rastet më të shpeshta kur personat juridik themelojnë OJQ i hasim tek rrjetet e organizatave të shoqërisë civile, odat ekonomike, shoqatat e bankave, shoqatat e naftëtarëve etj.

Dokumentet tjera të cilat kanë për qëllim përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e transparencës së OJQ-ve por që nuk kanë karakter detyrues janë: rregullorja e punës, rregullorja financiare, strategjia e organizatës, etj.

ORARI I PUNËS
 e hënë – e premte
 10:00 deri 14:00



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkesë për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkesë për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integritimit evropian
- **Sallën** e pajisur me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, buletinet dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë